



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.954/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Lux” SHPK me seli ne Lipjan rr. Hajredin Bajrami pn. me NUI 81712093 te cilin sipas autorizimit e përfaqëson N.T. avokat, ndaj debitorit “Doni Product” SHPK me selinë Ferizaj i cili sipas autorizimit përfaqësohet nga SCLR Partner shpk me seli ne Prishtine, bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkalles se parë, KPPP.nr.1368/22 të datës 22.05.2023, me datën 28.08.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit “Lux” SHPK me seli ne Lipjan rr. Hajredin Bajrami pn. me NUI 81712093, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkalles se parë, KPPP.nr. 1368/22 të datës 22.05.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkalles se parë, me aktvendimin e ankimuar, e ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit, dhe ka shfuqizuar urdhrin përmbarimor Pnr.844/2021 të datës 30.06.2021, i lëshuar nga Përmbaruesi Privat.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të vërtetimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj këtë ankesë si te bazuar, aktvendimin e ankimuar te anulohet, dhe te refuzohet prapësimi i debitorit.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit, në baze të faturave të listuara në aktvendimin e ankimuar dhe propozimin për Urdhër përmbarimor. Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbarimor Pnr.844/2021 të datës 30.06.2021, i ka lejuar përmbarimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit që rrjedh nga faturat t'i paguaj shumën 36,757.78€, si dhe shpenzimet procedurës përmbarimore.

Kundër urdhrin përmbarimor debitori ka paraqitur prapësim debitori me pretendimin që të aprovohet prapësimi dhe të shfuqizohet urdhri përmbarimor.

Gjykata Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkalles së parë, me aktvendimin e ankimuar, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi se faturat mbi bazën e se cilave është lejuar përmbarimi nuk janë pranuar nga debitori, të njëjtat fatura nuk janë nënshkruar nga personi-subjekti në emër dhe mbiemër dhe si të tilla nuk përbejnë bazë për përmbarim, ndërsa kreditori nuk ka mundur të argumentoj pretendimet e tij me asnjë provë me të cilin se faturat i janë dorëzuar debitorit.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të faturës së lëshuar nga kreditori, e cila fature nuk kanë qenë e nënshkruar nga pranuesi i faturës, e që në këtë rast nuk mund të konsiderohet si dokument i besueshëm. Neni 29 par.1 nënpar.1.1 përcakton se: “ 1. *Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.1 kambialet dhe çequet me potest dhe faturë kthyesë, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës*”. Në këtë rast e rëndësishme është që të vërtetohet se a është pranuar fatura nga ana e debitorit, pra e njëjta a është nënshkruar sepse kjo nënkupton se debitori i ka pranuar detyrimet e tij që i ka ndaj kreditorit.

Gjykata e shkalles së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar. Gjykata e shkalles së dytë bazuar në Udhëzimin administrativ Nr.15/2010 Për Zbatimin E Ligjit Nr. 03/L-222 Mbi Administratën Tatimore Dhe Procedurat, i cili në nenin 20 par.1 nënpar.1.17 parasheh që “*Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore*”, andaj, faturat si dokumente në sajë të cilave kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, nuk

ka prova se janë pranuar nga debitori, te njëjta nuk janë te vulosura e as nënshkruar nga debitori ne mënyrë qe te konsiderohen si dokumente te besueshme, ndërsa vlerëson se me te drejt gjykata e shkalles se parë ka vlerësuar se kreditori ne rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht te vlefshme ne mbështetje te pretendimeve te tij.

Përndryshe në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr.954/23, me datë 28.08.2023

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi